



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



DATË/A:	23/04/2018
REFERENC-Ë:	Zyrt. 04-96
PËR/ZA/TO:	Ofertuesit e ekskursionit për maturanët e Shkollës “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë
CC:	Shkolla “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Drejtorisë së Arsimit në Gjakovë
NGA/OD/FROM:	Komisioni selektues
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Njoftim


Njoftohen ofertuesit (agjensitë turistike) të licensuara, të cilat kanë marrur pjesë në ofertim për organizimin e ekskursionit të maturanëve të Shkollës “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë në Republikën e Shqipërisë, bazuar në ofertën e shpallur numër të protokollit 2185 të dt.06/04/2018 dhe pas shqyrtimit të ofertave, Komisioni selektues ka marrur Vendim 04 Nr.95 të dt.23/04/2018.

Këshilla juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afatin prej 8 ditësh, prej ditës së pranimit të së njëjtit. Ankesa i adresohet Sektorit të Inspektoriatit të Arsimit në Gjakovë.

Me respekt !



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC
OF KOSOVO



KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Drejtoria e Arsimit

04 Nr. 95

Më:23/04/2018

Duke u bazuar në UA nr.02/2016 Për Aktivitetet Jashtëshkollore i dt.12/01/2016, ofertën me numër protokolli 168 i dt.30/03/2018 lidhur me organizimin e ekskursionit për maturantë në Shkollën “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë, për bartjen e nxënësve në Republikën e Shqipërisë me qëndrim në Durrës. Nga Durrësi vizitohen: Kruja, Tirana, Tiranë, Vlora (ose Berati). Ekskursioni zgjat 4 bujtje (pansion i plotë) prej datës 27/04/2018 deri me 01/05/2018.

Lista e konkurrentëve për të fituar ofertën për ekskursion të maturantëve të Shkollës “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë:

1. “Shpatturs” me çmim 70.00 €;
2. “Kushtrimi - Nm ” me çmim 100.00 €;
3. “Norway Travel ” me çmim 90.00 €;

Raport i Komisionit selektues:

Hapja e ofertave u bë me dt.16/04/2017 në ora 13:30 sipas ofertës nr.2185 i dt.06/04/2018 ku prezent ka qenë përfaqësueset e Drejtorisë së Arsimit znj.Flutur Këpuska, znj.Vera Radoniqi Përfaqësueset e Këshillit Drejtues të Shkollës “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë, z.Neshet Këpuska – Drejtor i Shkollës “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë, z.Dardan Bakija – Zyrtar ligjor i ftuar në cilësi të vëzhguesit si dhe përfaqësuesit e kompanive konkurruese.

Të gjitha ofertat janë hapur dhe lexuar në praninë e kompanive konkurruese.

Firma transportuese “Shpatturs” ka konkuruar me çmim prej 70.00€ nga dt.27/04/2018 gjer me dt.01/05/2018 me katër (4) fjetje me pansion të plotë, sipas kërkesës së drejtorisë së shkollës “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë, iu është ofruar qëndrim në hotel “Bonita” që gjendet në plazhin e Durrësit te Shkëmbi i Kavajës. Posedon Certifikatën e Regjistrimit, Certifikatë – Deklarues i TVSH-ës, Certifikatën e Numrit Fiskal, Certifikatë lëshuar nga Dogana e Kosovës, Posedon Licencën D për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të lirë dhe të rregullt të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës. Posedon Vërtetimin nga ana e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik i cili nuk ka obligime ndaj taksës në firmë, Vërtetimin Tatimor lëshuar nga ana e

Administratës Tatimore e Kosovës, posedon licencën e punës për dr.Baton Lleshi, janë të përfshirë dy (2) shoferë e të pajisur me certifikatën mjekësore dhe janë prezantuar 2 autobusë.

Firma transportuese “Kushtrimi Nm” ka konkuruar me çmim prej 100.00€, sipas kërkesës së drejtorisë së shkollës “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë, iu është ofruar qëndrim në hotel “Diamond Resor” me pesë (5) netë fjetje dhe tre (3) vakte për ngrënie shëtitje në destinacionet e kërkuara nga ana e menaxhmentit të shkollës, po ashtu posedon edhe Akt – Miratim Higjeno Sanitar nr.42 të lëshuar nga ana e Republikës së Shqipërisë – Inspektorati Shtetëror Shëndetësor – Dega Rajonale Qarku Tiranë me nr.regjistrimi 1460 i dt.18/07/2016. Posedon Certifikatën e Regjistrimit, Certifikatën – Deklarues i TVSH-ës, Certifikatën e numrit fiskal, Vërtetimin Tatimor të lëshuar nga ana e Administratës Tatimore të Kosovës, Vërtetimin lëshuar nga ana e Kuvendit Komunal për obligimet e tatimit në pronë. Posedon Certifikatën e dr.Illir Grezda si dhe marrëveshjen me të nëse përzgjidhet nga ana e komisionit. Posedon Licencën D për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të lirë dhe të rregullt të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës. Ka prezantuar 4 (katër) autobus, janë përfshirë 4 (katër) shoferë e të pajisur me certifikatën mjekësore.

Firma transportuese “Norway Travel” ka konkuruar me çmim prej 90.00€, sipas kërkesës së drejtorisë së shkollës “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë, iu është ofruar qëndrim në hotel “Elba” – Premium Sh.P.K – Shkëmbi i Kavajës, me pesë (5) netë fjetje me pansion të plotë. Ka prezantuar në foto hotelin dhe dy autobusët që i ka në dispozicion. Ka prezantuar Licencën D për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të lirë dhe të rregullt të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, Certifikatën e Regjistrimit, Certifikatën – Deklarues i TVSH-ës, Vërtetimin Tatimor të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, Vërtetimin lëshuar nga Komuna e Gjakovës për obligimet e tatimit në pronë. Ka prezantuar kontratë bashkëpunim me hotel “Elba” që nga dt.01/04/2018 gjer me dt.01/01/2019 për akomodimin në këtë hotel, njëheri posedon Leje nga Republika e Shqipërisë – Minsitria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes – Qendra Kombëtare e Licencimit, Certifikatë të Regjistrimit të lëshuar nga Minsitria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për personit të tatueshëm “Elba Premium” – Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, si dhe Akt – Miratim Higjeno – Sanitar nr.3 të lëshuar nga Republika e Shqipërisë – Ministria e Shëndetësisë – Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë – Inspektorati Sanitar Shtetëror. Ka prezantuar kontratën e punës për znj.Teuta Blyta si dhe vërtetimin tatimor se personi në fjalë që është e regjistruar në ATK po ashtu edhe CPC Diplomë, ka prezantuar licencën e punës për dr.Selim Mehmeti dhe kontratën e tij të punës. Ka prezantuar 3 (tre) autobus, tre (3) shoferë të pajisur me certifikata mjekësore, si dhe ka prezantuar dy (2) letër referenca.

Vlerësimi i Komisionit selektues:

Pas shqyrtimit të ofertave të ofruara nga firma konkurruese, Komisioni selektues ka kërkuar të njoftohen të gjithë prindërit e fëmijëve pjesëmarrës në ekskursion lidhur me ofertat, ku me ç’rast të njëjtit janë ftuar nga mësimdhënësit kujdestarë të klasave dhe takimi është mbajtur në secilën klasë veç e veç. Nga prindërit është kërkuar Pëlqimi për përzgjedhjen e kompanisë për organizimin e ekskursionit, ku komisioni selektues me dt.28/03/2018 (e mërkure) është mbajtur mbledhja e Këshillit Drejtues të Shkollës “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë duke u bazuar në kërkesën e Këshillit të Nxënësve me dt.19/03/2018 dhe Mbledhjen e Këshillit Prindëror të mbajtur me dt.23/03/2018 si dhe kërkesën e menaxhmentit të shkollës “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë të

nënshkruar edhe nga ana e Kryetare të KDSH-ës znj. Florije Godeni për aprovimin e aktivitetit të paraparë me Planin Vjetor të Drejtorit të Shkollës drejtuar Drejtorisë së Arsimit në Gjakovë, Planin Vjetor i Punës së Drejtorit për vitin shkollor 2017/2018.

Komisioni selektues jep Vendim që nga ofertat e dorëzuara nga ofertuesit (agjensitë turistike) për Shkollën "Nexhmedin Nixha" në Gjakovë të përzgjedhet firma "Shpatturs" me çmim prej 70.00€

Pas shqyrtimit Komisioni vendosi ta zgjedhë agjencinë turistike "Shpatturs" me çmim prej 70.00 €

Shpatturs nga Gjakova

Arsyetim


Pas shqyrtimit të ofertave të ofruara nga firma konkurruese, Pëlqimit nga ana e Këshillit të Arsimtarëve të Klasëve të 12-ta (12 arsimtarë), Pëlqimit të Këshillit të Prindërve për secilën klasë veç e veç (për 10 klasë), listave për aprovimin e ekskursionit të nënshkruara nga prindërit e të gjithë nxënësve që do të marrin pjesë në ekskursion, Komisioni selektues jep Vendim që nga ofertat e dorëzuara nga ofertuesit (agjensitë turistike) për Shkollën "Nexhmedin Nixha" në Gjakovë të përzgjedhet firma "Shpatturs" me çmim prej 70.00€, pasi firma në fjalë ka konkuruar me 4 (katër) fjetje ashtu sipas ofertës me numër protokolli 2185 të dt.06/04/2018, dhe jo me 5 (pesë) fjetje siç janë prezantuar në ofertat nga dy (2) kompani tjera konkurruese.

Komisioni selektues:


1. Flutur Këpuska
(emri dhe mbiemri)


(pozita) dt.23/04/2018

2. Vera Radoniqi
(emri dhe mbiemri)


(pozita) dt.23/04/2018

3. Neshet Këpuska
(emri dhe mbiemri)


(pozita) dt.23/04/2018

Këshilla juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afatin prej 8 ditësh, prej ditës së pranimit të së njëjtit. Ankesa i adresohet Sektorit të Inspektoriatit të Arsimit në Gjakovë.

Vendimi iu dërgohet:

- Agjencie turistike, Sektorit të Inspektoratit të Arsimit në Gjakovë, Shërbimit juridik dhe Arkivit.